



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 330/5 Prot.

Tiranë, më 12.04.2023

V E N D I M

Nr. 59, Datë 12.04.2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 33 Regj., datë 01.03.2023, të paraqitur nga ana e Qendrës “Community Reporters Albania³”, kundër Televizionit Kombëtar Top Channel, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “racës dhe etnisë”, lidhur me formatin “Big Brother Albania Vip 2”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së sjellë pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues ka parashtruar se:

“Gjatë zhvillimit të spektaklit “Big Brother Albania Vip 2”, në datën 27.02.2023 gjatë mbërmbjes, qytetarja E. L, pjesëmarrëse në këtë format, gjatë një bisede me qytetarin L. E, ka ofenduar romët duke përdorur një term pezhorativ, konkretisht “arrixinjtë”, duke cituar pjesë nga biseda: “...O. G me atë kapacitetin e arrixhijes që ka atje poshtë...”.

Ky është një format që ndiqet nga miliona shqiptarë dhe përdorimi i këtyre termave ofendues denigron imazhin e minoritetit rom në Shqipëri, i cili mbart vlera gjuhësore, kulturore dhe është pjesë e shoqërisë shqiptare, ndër vite”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 1538, datë 30.09.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti ankues, ka kërkuar që nga ana e këtij televizioni të merren masa që gjatë transmetimeve direkte të kërkohej falje publike, lidhur me këtë episod të ndodhur, në mënyrë që kundrejt pakicave kombëtare rrome të ulet niveli i diskriminimit dhe perceptimit që krijohet tek publiku nëpërmjet këtyre mesazheve që transmetohen nga personazhet publike në të tilla formate e emisione televizive.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 1538, datë 30.10.2020, nëpërmjet së cilit Qendra “Community Reporters Albania” (referuar me akronimin CRA) është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare rrome në Shqipëri.

Mbështetur në përmbajtjen e Aktit të Themelimit dhe Statutin e Qendrës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

- “Të ofrojë praktika periodike trajnimi për gazetarinë online, televizion, raportim live, montazh video, audio prodhim, web media, blog;

- *Të kontribuojë në edukimin dhe sensibilizimin e publikut për rëndësinë e mediave në ndërtimin e ruajtjen e një demokracie ligjore dhe funksionale;*
- *Të promovojë nisma për afirmimin e të drejtave themelore të individëve dhe favorizimin e integritit mediatik dhe social të kategorive në nevojë;*
- *Të mbështesë nisma të ndryshme sociale nga komunitete dhe organizata jofitimprurëse me akses të kufizuar mediatik;*
- *Të zhvillojë dhe forcojë bashkëpunimin me partnerë, të tjera subjekte publike dhe private, institucione mediatike dhe institucione që ushtrojnë veprimtari social-kulturore apo që kanë qëllime të ngjashme dhe që i bashkon misioni dhe qëllimet;*
- *Të këshillojë institucione publike e subjekte të tjerë për çështje të hartimit të politikave të ndryshme mediatike dhe sociale;*
- *Të bashkëpunojë me grupet identitare për përmbushjen e qëllimit;*
- *Realizimin e projekteve dhe aktiviteteve që kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e integritin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane;*
- *Hulumtimin dhe dokumentimin, promovimin e kulturës dhe identitetit dhe të modeleve pozitive të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane;*
- *Bashkëpunimi me televizione të ndryshme për krijimin e organizimin e emisioneve të cilat nxisin reagimin qytetar dhe aktivizmin;*
- *Analiza mbi problematikat sociale dhe ligjore në kuadrë të nxitjes së politikave për përmirësimin e jetesës për këto minoritete Rome dhe Egjiptiane;*
- *Të krjojë raporte të ndryshme që kanë të bëjnë me median komunitare, çështje sociale dhe ligjore”.*

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë anëtarë të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës CRA, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Qendra, përfaqësuar nga B. Xh (Drejtor Ekzekutiv i CRA) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare Rome.

Mbështetur në përmbajtjen e emisionit *“Big Brother Albania Vip 2⁴”*, transmetuar në televizionin Top Channel, me datë 27.02.2023, rezulton se në shtëpinë ku zhvillohet ky spektakël dhe ku qëndrojnë një numër banorësh, mes banores E. L dhe banores tjetër O. G, ka agravuar debati gjatë një bisede mes tyre. Kështu, banorja E. L, pjesëmarrëse në këtë format dhe banore e shtëpisë, gjatë një bisede me banorin L. E, ka përdorur një term pezhorativ kundrejt banores O. G, konkretisht *“arrixhinjtë”*, duke cituar pjesë nga biseda: *“...O. G me atë kapacitetin e arrixhijes që ka atje poshtë...”*.

2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 330/1 prot., datë 09.03.20213 kërkoi informacion nga televizioni Top Channel, lidhur me pretendimet e palës ankuese.

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=7ksxRTm-EA>, minuta 3:28 e transmetimit gjatë kësaj videoje.

Nëpërmjet shkresës me nr. 189/1 prot., datë 17.03.2023, televizioni Top Channel, ka parashtruar, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

“Për shkak të gjuhës së përdorur brenda shtëpisë dhe programit Big Brother Vip 2, Top Channel së bashku me produksionin e këtij programi, ka vendosur që E. L të largohet nga shtëpia e BB Vip 2, duke u skualifikuar nga loja. Largimi i është komunikuar më datë 01.03.2023, nëpërmjet zarfit të zi brenda shtëpisë së BB Vip 2. Ky largim ka qenë për shkak të gjuhës së përdorur nga E. L, gjuhë e cila bie ndesh me kontratën e firmosur prej saj, si dhe legjislacioni në fuqi, veçanërisht me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Gjithashtu, E. L nuk është lejuar që të jetë e pranishme në asnjë Prime Time të programit Big Brother Vip 2.

Produksioni disponon të gjitha videot dhe audiot në bazë të të cilave janë marrë masat e largimit nga shtëpia për banoren E. L”

3. Në vijim të përgjigjes së mësipërme të Top Channel, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 330/3 prot., datë 21.03.2023, ka kërkuar nga ana e këtij Televizioni të depozitohet pranë KMD-së, provat (video, audio) të cilat provojnë deklarin se ata kanë marrë masat lidhur me fjalorin dhe gjuhën e përdorur nga E. L kundrejt banores tjetër O. G, duke iu drejtuar asaj me shprehjen pexhorative “...me kapacitetin e arrixhies...”, si term fyes në drejtim të pakicave kombëtare Rome. Gjatë bisedës së zhvilluar evidentohet se mes banoreve është debatuar edhe në rrafshin personal, duke iu drejtuar në mënyrë direkte njëra tjetrës.

Në përmbushje të kërkesës së mësipërme të Komisionerit, Shoqëria Top Channel sh.a, nëpërmjet shkresës me nr. 215/1 prot., datë 27.03.2023, vuri në dispozicion të KMD-së, CD me materialet që faktojnë largimin nga shtëpia e Big Brother Vip 2, të banores E.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Nga verifikimi i përmbajtjes së emisionit Big Brother Vip 2, të datës 28.02.2023, transmetuar në televizionin Top Channel, (pas emisionit Prime Time të datës 27.02.2023) rezulton se, në ambientet ku zhvillohet ky spektakël dhe ku qëndrojnë një numër banorësh, mes banores E. L dhe banores tjetër O. G, ka agravuar debati gjatë një bisede mes tyre. Kështu, E. L, pjesëmarrëse në këtë format dhe banore e shtëpisë, gjatë një bisede me banorin L. E, lidhur me debatet që ka patur me banoren O. G, ka përdorur një term pezhorativ kundrejt saj, konkretisht “arrixhinjtë”, duke cituar pjesë nga biseda: “...O. G me atë kapacitetin e arrixhijes që ka ...”.

Nga materialet e depozituara dhe regjistrimet audiovizive⁵ të emisionit Big Brother Vip 2, në televizionin Top Channel, konstatohet se, të nesërmen e kësaj ndodhie, me datë 01.03.2023,

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=NrNMpS2TAqo>

në ambientet e shtëpisë ku zhvillohet e transmetohet drejtëpërdrejtë (gjatë 24 orëve në dy kanale të dedikuara specifikuara) ky spektakël, produksioni ka dërguar një zarf të zi, përmbajtja e të cilit iu lexua të gjithë banorëve të shtëpisë nga L. E, momente këto të transmetuara e përcjella në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe për publikun që i ndjek nga ekrani. Përmbajtja e tekstit të përcjellë nga ana e produksionit është si më poshtë citohet:

“Banorë, Vëllai i Madh ju ka dhënë mbrëmë ultimatumin e fundit për mosrespektimin e rregullave thelbësore të formatit të Big Brother, që nuk lejojnë të çënohet integriteti i askujt. Dhuna verbale e përdorur mbrëmë në formë të përsëritur nga banorja E, përbën një shkelje të rëndë të rregullave. Për këtë arsye, Vëllai i madh, ju komunikoi se banorja E, lë menjëherë shtëpinë dhe është e skualifikuar nga loja”.

Komisioneri gjykon se, realizimi dhe transmetimi i emisioneve të tilla televizive dhe jo vetëm, është në funksion të qëllimeve dhe detyrës së vetë medias/televizionit, me synim argëtimin, përfshirjen dhe bërjen pjesë të saj edhe të publikut që i ndjek nga ekrani i televizionit, të këtij formati spektakli i cili zhvillohet e transmetohet live/drejtëpërdrejtë në dy kanale televizive të dedikuara posaçërisht këtij formati, nëpërmjet shprehjes së vullnetit të ndjekësve nëpërmjet televotimit lidhur me mbështetjen që ata mund t’u japin banorit apo banorëve të tyre të preferuar.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vëren se, duke qenë se transmetimi i këtij formati është një transmetim që bëhet drejtëpërdrejtë në televizion gjatë 24 orëve, për këtë shkak veprimet, komunikimi verbal, gjuha e përdorur apo sjellje të caktuara të banorëve nuk është e mundur të parashikohen e parandalohen sikurse ishte rasti i gjuhës së përdorur nga banorja E. L.

Nga sa më lart, Komisioneri gjykon se veprimet e ndërmarra nga ana e produksionit të emisionit Big Brother Vip 2, kanë qenë konkrete dhe të shpejta në reagim të gjuhës së përdorur nga banorja në fjalë, e cila ishte pjesë e këtij formati. Ajo është skualifikuar nga loja pikërisht për shkak të masës që u ndërmor nga ana e produksionit, ndaj gjuhës fyese e të papërshtatshme të përdorur prej saj, masë e cila i është komunikuar drejtëpërdrejtë si banorëve të shtëpisë, ashtu edhe teleshikuesve të këtij formati, nëpërmjet leximit të përmbajtjes së zarfit të zi nga banori L. E.

Ligji nr. 97/2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, është “rregullatori” i veprimtarisë së mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 4 të tij, ky ligj ka përcaktuar se:

“1. Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve:

- a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë;*
- b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve;*
- c) veprimtaria e transmetimeve audiovizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar;*

- ç) veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;
- d) veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, ky ligj ka përcaktuar edhe se, operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parime si:

- a) garantimi i lirisë së shprehjes;
- b) garantimi i së drejtës së informimit;
- c) ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit;
- ç) respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private;
- d moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;
- dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën;
- e) garantimi i së drejtës së përgjigjes;
- ë) garantimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të;
- f) respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve;
- g) respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të tij, pra edhe për shkak të *racës e etnisë* dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

LMD, në nenin 3, pika 8 e tij, ka përcaktuar se, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Po ashtu, në pikën 13, të po këtij neni, ka përkufizuar “*Shqetësimin*”⁶ si formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e mbrojtura, i cili ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në

⁶“*Shqetësim*” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷.

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash, besimesh fetare dhe mënyrash jetese, ndonjëherë është e nevojshme që e drejta për lirinë e shprehjes të ekuilibrohet me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi. Arritja e kësaj mbrojtjeje, bëhet përmes balancës mes tyre, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një “shoqërie demokratike”.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjisllacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Legjisllacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes.

“Gjuha e urrejtjes” kundër personave që i përkasin pakicave kombëtare Rome, ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj individëve të këtyre pakicave. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

“Gjuha e urrejtjes” për qëllim të Rekomandimit ECRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes, si: mbrojtja, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin “raca”, ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, paaftësia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual⁸.

Ligji për Mediat Audiovizive garanton se aktiviteti i transmetimit i shoqërive të jetë në përputhje me të drejtën për informacion, e bindjeve politike dhe fetare, personalitetin, dhe dinjitetin si dhe me të tjera të drejta dhe liri themelore të njeriut. Transmetimi mediatik duhet të udhëhiqet nga parimet e “moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve”.

⁷ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁸ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

Ligji parashikon se shërbimi i mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të përmbajë asnjë nxitje ndaj urrejtjes mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare (Neni 32). Operatorët e shërbimeve audiovizive nuk lejohen të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi (Neni 76).

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive përfshin dhe përcakton parimet, rregullat, kushtet dhe praktikat për transmetimin audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar si instrument zbatues i ligjit Për Mediat Audiovizive në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/13 (“Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive”) dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si KEDNJ. Kodi përshkruan disa parime për shërbimet audiovizive midis të cilave janë dekurajimi i urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit për shkaqe të tilla si raca, gjinia, orientimi seksual, besimit politik (1.5); respektimi i së drejtës për barazi; dhe mosdiskriminim nga transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve (1.12).

Gjatë analizimit e shqyrtimit të pretendimeve të subjektit ankues, lidhur me terminologjinë e papërshtatshme të përdorur nga banorja E. L. përsa i takon termit “kapacitet arrixhije” duke e konsideruar si gjuhë fyese kundrejt anëtarëve të pakicave kombëtare Rome, Komisioneri vlerëson se, një fakt i tillë është pranuar nga ana e prodhuesit të emisionit Big Brother Vip 2, pasi pikërisht për shkak të konstatimit nga ana e tyre për përdorimin e gjuhës fyese e denigruese kanë marrë edhe masat për skualifikimin e saj nga loja dhe largimin përfundimisht nga shtëpia e BB Vip 2. Lidhur me këtë veprim të tij, prodhuesi ka informuar edhe publikun në transmetimin e drejtëpërdrejtë të këtij emisioni. Në këtë kontekst, publikut i është bërë e ditur se nga ana e prodhuesit nuk do të tolerohej gjuha fyese (dhuna verbale) dhe cënimi i integritetit të askujt, dhe se do të ndërmerreshin masa kundrejt cilitdo banor që bën veprime të tilla, sikurse ishte rasti i përjashtimit nga loja të banores E. L.

Në këtë kuptim, Komisioneri vëren se, qëndrimi i prodhuesit gjatë emisionit të transmetuar direkt, me datë 01.03.2023, tregon qartazi se veprimet e masat e ndërmarra pre tyre për skualifikimin e banores E. L. për gjuhën e përdorur prej saj, janë të drejta, të menjëhershme, transparente për publikun dhe në mbrojtje të integritetit të kujtqo që mund të preket, cënohet a shqetësohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë.

Pra, në këtë kontekst, nga ana e prodhuesit janë marrë masat e duhura e të nevojshme lidhur me përdorimin e gjuhës fyese e të papërshtatshme nga ana e një prej banorëve të shtëpisë Big Brother Vip 2, duke e skualifikuar atë nga loja.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, për shkak të gjuhës së përdorur brenda shtëpisë dhe programit Big Brother Vip 2, në datën 27.02.2023, Top Channel së bashku me prodhuesin e këtij programi, ka vendosur që E. L. të largohet nga shtëpia e BB Vip 2, duke u skualifikuar nga loja. Largimi i është komunikuar më datë 01.03.2023, nëpërmjet zarfit të zi brenda shtëpisë së BB Vip 2. Ky largim ka qenë për shkak të gjuhës së përdorur nga E. L. gjuhë e cila bie ndesh me kontratën e firmosur prej saj, si dhe legjislacioni në fuqi, veçanërisht me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Top Channel, si subjekti kundër të cilit është drejtuar ankesa, janë kryer të gjitha veprimet e janë marrë masat e duhura, kundrejt një prej banoreve të shtëpisë së Big Brother Vip 2, për shkak të gjuhës së përdorur prej saj, të cilësuar si gjuhë denigruese e dhunë verbale kundrejt kujtdo personi që ajo i drejtohet apo targeton. Po ashtu, këto masa janë komunikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe për publikun që i ndjek nga ekrani, në transparencë të plotë dhe duke bërë të qartë faqe opinionit publik edhe qëndrimin e distancimin e tyre si televizion kundrejt gjuhës së përdorur nga banorja E. L.

Për rrjedhojë, në situatën e analizuar më sipër rezulton qartë që nga ana e produksionit të emisionit Big Brother Vip 2 dhe televizionit Top Channel, të cilët janë dhe subjektet/autoritetet përgjegjëse lidhur me detyrimin ligjor që ju buron për mbarëvajtjen e këtij formati/emisioni, nuk ka patur veprime apo qëndrim të tillë që të ketë vënë në pozita diskriminuese përmes tolerimit të përdorimit të gjuhës fyese e denigruese, kundrejt asnjë personi, pjesëtar i cilitdo komunitet apo pjesë e pakicave kombëtare qoftë ai.

Përkundrazi, në respektim të mostolerancës së gjuhës së urrejtjes, produksioni ka marrë masat e duhura, duke përçarur njëkohësisht këtë mesazh edhe për publikun që i ndjek nga ekrani. Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja b), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të racës dhe etnisë, ndaj pakicave kombëtare Rome, përfaqësuar nga Qendra “Community Reporters Albania”, nga ana e Shoqërisë Top Channel sh.p.k⁹.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁹ Si personi jurik përgjegjës për emisionin Big Brother Vip 2, të transmetuar në televizionin Top Channel.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Raca, etnia